# DËSHMI ARKIVI

**A-447957**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Banesat pa dokumente pronësie, Kadastra zbret në terren në 23 fshatra të Himarës/ Publikohet kalendari me datat e evidentimit derë më derë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/banesat-pa-dokumente-pronesie-kadastra-zbret-ne-terren-ne-23-fshatra-te-himares-publikohet-kalendari-me-datat-e-evidentimit-dere-me-dere/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 07:50:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 07:46:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 07:45:00 UTC → 16 shtator 2026, 07:47:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `223805c212559ce402e202230706bfb2ea788e20882a5aca62a959c1c0c6aea3` |
| TEKSTI | `f6b737354d26031432fb17371b32e7894b2749cccc32367bbdb2609b6dcd07f5` |
| PAMJA | `10eebae698340c8e8dfa9f39dfee36c0b0399b9211d5e241619f9eca7961b600` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fde39ac168c0bc1beb36268467d6c3a345c6b8873b225342f70b59bfc4fe4ebf` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fde39ac168c0bc1beb36268467d6c3a345c6b8873b225342f70b59bfc4fe4ebf`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# Banesat pa dokumente pronësie, Kadastra zbret në terren në 23 fshatra të Himarës/ Publikohet kalendari me datat e evidentimit derë më derë

16/09/2026 09:46



**Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka nisur punën në terren për evidentimin dhe trajtimin e banesave që vijojnë të jenë pa dokumentacion pronësie.**

Procesi ka nisur në 23 fshatra të Himarës, ku ekipet e ASHK-së do të jenë të pranishme sipas një kalendari të përcaktuar.

Qëllimi i kësaj nisme është që problematikat e dokumentacionit, regjistrimit apo përcaktimit të statusit të banesave të identifikohen dhe të trajtohen drejtpërdrejt në territor, duke e afruar shërbimin kadastral me qytetarët.

Nëpërmjet punës derë më derë, specialistët e ASHK-së do të kontaktojnë banorët e zonave të përfshira, veçanërisht familjet që përballen me problematika të trashëguara të dokumentacionit të pronësisë.

Sipas kalendarit të publikuar nga ASHK, puna ka nisur në Palasë, ku ekipet do të jenë të pranishme nga 10 deri më 18 shtator.

Procesi vijon si më poshtë:

Gjilekë, Dhërmi, Ilias dhe Vuno: 21 shtator – 5 tetor

Himarë: 21 shtator – 25 nëntor

Pilur, Kudhës dhe Qeparo Fshat/Fushë: 6 – 16 tetor

Kallarat, Vranisht, Tërbaç, Bolenë dhe Kuç: 19 – 26 tetor

Borsh, Fterrë dhe Çorraj: 27 tetor – 9 nëntor

Piqeras, Bunec/Sasaj, Lukovë, Shën Vasil dhe Nivicë/Heremec: 10 – 20 nëntor

Shërbimi zhvendoset pranë banorëve

Sipas ASHK-së, qasja e re synon të lehtësojë procedurat për qytetarët, sidomos për banorët e zonave rurale, të cilët shpesh përballen me problematika të vjetra sa i përket dokumentacionit dhe regjistrimit të pronës.

Në vend që qytetarët të udhëtojnë drejt zyrave për të ndjekur procedurat, ekipet e institucionit do të jenë në territor për të evidentuar problematikat dhe për të orientuar banorët mbi zgjidhjet e mundshme për pronat e tyre.

ASHK u bën thirrje banorëve të 23 zonave të përfshira në këtë proces që të njihen me datat e prezencës së ekipeve dhe të shfrytëzojnë kontaktin e drejtpërdrejtë me specialistët për problematikat që lidhen me dokumentacionin e banesave dhe pronësinë.

## Kryesore



LIVE/ Pas gati 6 vitesh paraburgim, gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së
07:33

"Ne jemi napolitanët e anës tjetër", Rama në ceremoninë e hapjes së Konsullatës Shqiptare në Napoli: Kemi hapur një derë mes dy realiteteve të afërta
08:09

I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit pranon ekstradimin e Ervin Matës drejt Shqipërisë
07:40

CEO i OpenAI pranon rreziqet e inteligjencës artificiale: Bota ka të drejtë të ndiejë frikë nga ajo që mund të ndodhë
07:20

Rrëzohet helikopteri pranë një zone tregtare në Los Angeles, 3 persona humbin jetën
07:13

## Më të lexuarat

"Daja i deputetes më ka përdhunuar", Zegjine Çaushi reagon pas denoncimit të 34-vjeçares, publikon foton e tyre si çift: Më thanë se do martohen

"Kryetari i pagëzuar rishtaz nga Kushtetuesja nuk mund të lëvizë nga qelia"/ Vendimi për Veliajn, Rama: Rast unikal në historinë e Europës demokratike

"Po e vendosin njerëzimin në rrugën e shkatërrimit", Rusia sulmon SHBA-në pasi pranoi se ka sisteme armësh në hapësirë

U dënua me 20 vite burg për gjakmarrje dhe më pas u shpall i pafajshëm, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim çështjen e Ergys Kolaverit

Rama udhëton drejt SHBA-së në 20 shtator, zbardhen detaje nga takimet që pritet të zhvillojë

"Puna e SPAK, efektive", mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale

Japonia thyen rekorde, kalon për herë të parë shifrën e 100 mijë persona mbi moshën 100-vjeçare, pjesa më e madhe janë gra

Pamje si në filma, anëtarët e mafies italiane organizojnë garë të paligjshme me kuaj në autostradë, e shoqërojnë me breshëri

plumbash

Misteri i vdekjes së Giorgos Mazonakis, fotoja e fshirë që po hetohet nga Policia

I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit pranon ekstradimin e Ervin Matës drejt Shqipërisë

Top Channel

## Aktualitet »



Po transportonte 6 shtetas të huaj drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Korçë

16/09 09:26



"Paketa e Maleve" ankimohet në Gjykatën Kushtetuese, çështja kalon për shqyrtim në seancë plenare

16/09 08:28



I akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, Gjykata Supreme e Brazilit pranon ekstradimin e Ervin Matës drejt Shqipërisë

16/09 07:40



Moti ndryshon pas mesditës/ Reshje shiu në zonat malore, temperaturat deri në 32°C

16/09 07:06



"Puna e SPAK, efektive", mesazhe të forta nga zyrtari i DASH, Lawton: Po punojmë me Shqipërinë për të goditur organizatat kriminale transnacionale

15/09 23:51



"Daja i deputetes më ka përdhunuar", Zegjine Çaushi reagon pas denoncimit të 34-vjeçares, publikon foton e tyre si çift: Më thanë se do martohen

15/09 21:51

## Kryesore »



Europa League ngre sot siparin, sytë te Milan-Benfica, Dinamo e Zagrebit e Arbër Hoxhës mat forcat me Hapoel Beer Sheva

16/09 09:48



BE-Kinë, von der Leyen: Marrëdhënia tregtare është "e paqëndrueshme", deficiti arrin 1 miliard euro në ditë

16/09 09:32



Në pritje të vendimit në Hagë, familjarët e Hashim Thaçit dhe Rexhep Selimit hyjnë në gjykatë

16/09 09:16



Pak para vendimit në Hagë, mbështetësve të Thaçit dhe ish-krerëve të UÇK-së u kërkohet të largohen nga hapësirat para gjykatës

16/09 09:15



Sulmet me dronë i afrohen territorit të NATO-s, Polonia përforcon kufirin me Ukrainën

16/09 08:37



"Paketa e Maleve" ankimohet në Gjykatën Kushtetuese, çështja kalon për shqyrtim në seancë plenare

16/09 08:28

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – UÇK 'zbarkon' në



Top Channel/ Tinderi "zbulon"



Top Channel/ "IA është si një


Hagë në pritje të vendimit ndaj udhëheqëve të luftës

një skandal në NATO/ Oficeri spanjoll përfundon nën hetim

inteligjencë aliene", Bill Gates ngre alarmin për atë që po vjen

Top Channel/ SHBA nis shkurtimet për ushtrinë në Ballkan, preket Maqedonia e Veriut

Top Channel/ Dyfishohet bonusi për pensionistët, vendimi nis më 1 janar 2027

Top Channel/ "Ethet" e vendimit në Hagë, nesër verdikti i gjykatës për liderët e UÇK

**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.